



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 118, Datë 04.06.2018

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SONNE” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK TOPOJË ME FUQI TË INSTALUAR 1998 KW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4 pika 1 gërma “a”; neni 5 pika 1 gërma “a” dhe neni 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW,

Konstatohet se:

- Me shkresën nr.3 Prot, datë 01.02.2018, protokolluar në ERE me nr.149 Prot, datë 02.02.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Topojë me kapacitet të instaluar 1998 KW.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 53, datë 07.03.2018, vendosi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Topojë me kapacitet prodhues 1998 KW, për shkak të mangësive në dokumentacionin e depozituar.
- Me shkresën nr.6 Prot., datë 30.03.2018, dhe protokolluar në ERE me nr. 149/3 Prot., datë 03.04.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka ri-aplikuar për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW.

- Në nenin 10, pika 7 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*” parashikohet se : “*Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimi për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.*”
- Rezulton se aplikimi i shoqërisë është paraqitur brenda afateve të parashikuara në dispozitat më sipër.
- Shoqëria “SONNE” sh.p.k. ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën me nr. 2278 Rep dhe nr. 1052/3 Kol., datë 12.10.2017, për "Ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë" me kapacitet prodhues 1998 KW, në Bashkinë Fier, Qarku Fier, bazuar në nenin 25 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015.
- Në vijim, bordi i ERE me vendimin nr. 89, datë 20.04.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier me kapacitet të instaluar 1998 kW, për një afat 20 vjeçar.
- Me shkresën nr. 55/19 Prot., datë 24.04.2018, është bërë njoftimi në median e shkruar, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik dhe pas përfundimit të afatit 20 ditor të paraqitjes së objeksioneve ose ankesave, lidhur me këtë aplikim, nuk rezulton të jetë depozituar në ERE asnjë ankesë ose objeksion.
- Aplikimi i shoqërisë “SONNE” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”:
 - Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3; 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, Topojë me fuqi të instaluar 1998 KW, për një afat 20 – vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari

Petrit AHMETI